**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Adresa:rr."Adem Jashari" pn, ëëë.gjilani-komuna.org; e-mail:zip_gjilan@hotmail.com,tel.0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 38 paragrafi 1.8 dhe 1.19, nenin 39 paragrafi 1 pika 4 të Statutit të Komunës së Gjilanit, 01.Nr.16-53125 të datës 11.11.2011, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Arsim dhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa 01.nr.59/2014 të datës 23.09.2014, në Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur me 29.09.2014 miraton këtë:

# V E N D I M
## PËR AUTORIZIMIN E KOMITETIT PËR ARSIM PËR HARTIMIN E KRITEREVE PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASAT E PARA

1. Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Gjilanit AUTORIZON Komitetin për Arsim që në bashkëpunim me Drejtorinë për Arsim të hartojnë kriteret për regjistrimin e nxënësve në klasat e para si dhe kriteret për ndarjen e nxënësve të klasave të para nëpër klasë.

2. OBLIGOHET Komiteti për Arsim dhe Drejtoria për Arsim që pas hartimit të kritereve si në pikën 1. të këtij vendimi, të njëjtat t'i propozoj Kuvendit të Komunës së Gjilanit për miratim.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Komiteti për Arsim dhe Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa për implementimin e tij kujdeset Kryesuesi i KK-Gjilan.

4. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01.Nr._016-113371__
Gjilan, më 29.09.2014

Kryesuesja e Kuvendit,
____________________
Valentina Bunjaku-Rexhepi,